MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë**, me objekt: *"Mbi realizimin e të ardhurave doganore në vitin ushtrimor 2011, planifikimi i buxhetit të DPD-së dhe realizimi faktik i tij për periudhën 2010-2011"* dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 134, datë 14/9/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 510/11, datë 14/09/2012, ***dërguar Z. Flamur Gjymishka, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave,*** krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të analizojë me të gjithë stafin, Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin janë paraqitur shkeljet e konstatuara, ndërkohë të përgatisë një program pune të veçantë me persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të dërguara bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

Menjëherë

2. DPD bazuar në ndarjen territoriale, duke i dhënë përparësi përmirësimit cilësor të veprimtarisë së saj trajnuese, të ndikojë në mundësimin e pjesëmarrjes në programimin e të ardhurave doganore të punonjësve të Degëve Doganore në rrethe, sikurse veprojnë për treguesit e tjerë të buxhetit, duke u bazuar në të dhënat që disponojnë për periudhat e mëparshme, në raportet që nxjerrin nga sistemi apo që përpunohen nga Drejtoria e Statistikës.

Menjëherë

3. DPD të rrisë më shumë rolin e saj mbikëqyrës mbi degët doganore nëpërmjet kontrolleve të ndryshme të strukturave të saj të specializuara, sidomos për funksionimin e regjimeve ekonomike, duke shfrytëzuar të gjithë bazën ligjore fiskale për maksimizimin e të ardhurave doganore.

Menjëherë

4. Duke marrë shkas nga pamundësia e verifikimit në sistem të mbylljes së deklaratave të lejimit të përkohshëm, kontrollet duhet të realizohen nëpër degët doganore, duke rritur kohën e kontrollit dhe kostot administrative. Gjithashtu nga Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë të shikohet mundësia që deklaratat IM5

për lejimin e përkohshëm të marrin automatikisht një numër identifikues nga sistemi. Ky numër duhet të vendoset nga sistemi në deklaratën e mbylljes së këtij regjimi, duke e bërë lehtësisht të evidentueshme dhe të kontrollueshëm zbatimin e autorizimeve për Rregjimit të Lejimit të Përkohshëm (RLP). Mbikëqyrja e regjimit si nga ana degës doganore dhe e DPD të mos bëhet duke iu referuar numrit të regjistrimit të deklaratave nga dega doganore në mënyrë manuale, por numrit të regjistrimit në sistemin e Asycuda ++ ose Asycuda Ŵorld. Një përmirësim i tillë do të shkurtonte kostot e kryerjes së kontrolleve nëpër degë doganore nga DPD, pasi do të shikoheshin lehtësisht në sistem nga një operator.

Menjëherë

5. Të ndiqen procedurat ligjore për sistemimin e veprimeve kontabël për Aktivitetet e Qëndrueshme të Trupëzuara, ish parkingu në Degën Doganore të Tiranës për vlerën **21,365,570** lekë, rekomandim i dërguar me shkresën nr.10/8, datë 25/5/2010 të KLSH-së.

Menjëherë

6. Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9228 datë 29/4/2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve" pika 1, ku thuhet: "Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse" dhe pika 2, gjatë vitit 2012, të organizohet puna për kryerjen e inventarëve duke trajtuar edhe materialet për jashtëpërdorimit. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.

Menjëherë

7. Të ndiqen Arkëtimi i detyrimeve të papaguara për periudhën *deri më 31/12/2006 për shumën 284,486,985 lekë,* si dhe të ndiqet problemi i vënies në dispozicion të Sektorit të Borxhit të një programi elektronik, me synim që direkt nga Degët e Doganave, të transmetohen të gjitha të dhënat që përmban dosja e borxhit dhe veprimet ligjore që zbatohen për çdo subjekt debitor.

Menjëherë

8. DPD nëpërmjet strukturave të saj të specializuara të rrisë rolin në drejtim të marrjes së masave *për rikuperimin me forcë të borxhit për vlerën totale 2,959,229,950 lekë*, përfshirë edhe shumën e borxhit tatimor të sipër shënuar deri më 31/12/2006. Vëmendje e veçantë t`i kushtohet ndjekjes së debitorëve të trashëguar ndër vite dhe atyre të krijuar nga mungesa e korrektësisë së subjekteve

dhe për pagesën e t.v.sh.-së së shtyrë (2009-2011) të cilët përbëjnë 32,4% të totalit të borxhit doganor dhe në vlerë 960,100,093 lekë.

Menjëherë

9. Të ndiqen me përparësi *arkëtimi i detyrimeve të prapambetura për vlerën 2,694 mijë lekë,* të zbuluara nga KLSH për periudhën 1999, 2001 dhe 2002 në vlerën 1,280 mijë lekë, nga auditimi i MF 380.2 mijë lekë dhe diferencat e inventarit për vlerën 1,008 mijë lekë duke zbatuar për këtë qëllim gjithë bazën ligjore.

Menjëherë

10. Për çdo rast të marrjes së masës së largimit nga shërbimi civil i punonjësve doganor, në zbatim të neneve 21 e 22, të ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kur punonjësi i larguar ka fituar të drejtën e rikthimit në punë dhe dëmshpërblimin në pagë, të analizohet dhe të dalë përgjegjësia nga personat përgjegjës që nga fillimi i ecurisë disiplinore.

Menjëherë

11. Të zbatohen procedurat për administrimin e kërkesave dhe plotësimin e dokumentacionit për vendet vakante të punës, sipas kërkesave të ligjit nr. 8449, datë 27/1/1999 "Kodi Doganor i RSH", me ndryshime dhe VKM nr. 205, datë 13/4/1999 "Për dispozitat e Kodit Doganor", me ndryshime.

Menjëherë

12. Nga Drejtoria e Organizim Personelit dhe Trajnimit në DPD, të kryhet inventarizimi i dosjeve të personelit, bazuar kjo në kërkesat e nenit 26, të ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999 "Statusi i Nëpunësit Civil" dhe pikës nr. 1, të VKM nr. 355, datë 7/7/2000 "Për organizimin e dosjes së Regjistrit të Personelit", Aneksi 1.

Menjëherë

13. Drejtoria e Organizim Personelit dhe Trajnimit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në DPD, të ndërmarrin propozime ligjore për përmirësimin e procedurave të rekrutimeve në punë të punonjësve, për specifikimin e "rasteve specifike", të cituara në pikën 11.10.8 të VKM nr. 274, datë 13/4/2010 "Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 205, datë 13/4/1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar.

Menjëherë

14. Të merren masa dhe të ndiqen nga Sektori i Financës, procedurat për administrimin dhe dokumentim me fletëhyrje në magazinën e DPD. Të gjitha pjesët e vjetra të këmbimit, të cilat subjekti riparues duhet t'i kthejë në mënyrë që të bëhet magazinimi i tyre në magazinë, sipas përcaktimit në pikën 3 të

autorizimeve të lëshuara nga zv/Drejtori i Përgjithshëm dhe të parashikuara qartë me nenin 6 “Të drejtat dhe detyrimet e të porositurit”, të Kontratës së lidhur midis palëve

Menjëherë

15. Të merren masa dhe të ndiqet nga Njësia e Prokurimit, që në të ardhmen për të gjithë tenderët që do të zhvillojë, argumentimi dhe llogaritja e fondit limit të jetë pjesë përbërëse e administruar në dosjen e tenderit për çdo procedurë prokurimi e përllogaritur në momentin e hartimit dhe miratimit të projekt/buxhetit të vitit përkatës.

Menjëherë

16. Të merren masa dhe të ndiqet nga Njësia e Prokurimit, që në të ardhmen, për tenderin me objekt “*Shërbimi i ruajtjes me roje civile*”, argumentimi dhe përllogaritja e vlerës së fondit limit të jetë pjesë përbërëse e administruar në dosjen e tenderit, nëpërmjet përcaktimit të qartë, të planit të organizimit, të skemave të ruajtjes, të planimetrisë dhe sipërfaqen e objekteve që kryhet shërbim, në pozicionin e vendrojave dhe distancat midis tyre, faktorë dhe kusht që eliminojnë mbivendosjet dhe dublimet e vendrojeve.

Menjëherë

17. Të merren masa dhe të ndiqet nga Sektori i Analizës së Riskut, përmirësimi i analizës së riskut, duke rritur bashkëpunimin midis sektorëve dhe drejtorive të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Agjencitë e tjera që veprojnë në kufi.

Menjëherë

18. Të merren masa dhe të ndiqet nga Sektori i Analizës së Riskut përmirësimi i sistemit “Feedback” për raportimin dhe përpunimin e rezultateve të kontrolleve të ushtruara nga degët doganore, sipas përcaktimeve të sistemit të kontrolleve, të dhëna në bazë të riskut lokal, apo edhe në kontrollet e ushtruara nga strukturat e tjera.

Menjëherë

19. Përveç rezultateve të kontrolleve, Sektori i Analizës së Riskut, duhet që në raportimet që kryen, të pasqyrojë në përmbajtje dhe në detaje parregullsitë e konstatuara gjatë monitorimeve nëpërmjet rikanalizimeve në kanalin e kuq.

Menjëherë

20. Të merren masa nga Komisioni i Menaxhimit të Riskut (KMR), nëpërmjet Sektorit të Analizës së Riskut për të rritur numrin e profileve të riskut, me qëllim mbulimin më të mirë të riskut dhe rritjen e kontrolleve të targetuara.

Menjëherë

21. Të merren masa për të garantuar efektivitetin dhe funksionimin më efiçent të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të kërkohet pjesëmarrja dhe angazhimi në këtë proces edhe i njësive shpenzuese në vartësi të strukturave të njësisë qendrore shpenzuese të DPD-së.

Menjëherë

22. Të merren masa nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që rekurtimi i audituesve të jetë një proces transparent dhe përzgjedhja e tyre të bëhet ndërmjet punonjësve të cilët janë të pajisur me certifikatën "*Auditues i brendshëm në sektorin publik*".

Menjëherë

23. Të merren masa që veprimtaria audituese të fokusohet në vlerësimin e funksionimit mbi bazë sistemesh, veçanërisht të sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e riskut dhe performancës e monitorimit, në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit për DPD.

Menjëherë

24. Të merren masa që të sigurohet miratimi i Manualit specifik të auditimit të brendshëm për DPD, në përputhje me rekomandimet e NJQHAB, të Ministrisë së Financave.

Menjëherë

25. Të merren masa që procesi i sigurimit të cilësisë së punës audituese të kryhet nëpërmjet rishikimit të detajuar të cilësisë së auditimit, brenda njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohet arkëtimi në rrugë ligjore i detyrimit **në vlerë 4,932,000 lekë për 134 punonjës**, që përfaqëson pagesa të kryera në kundërshtim me kapitullin e III, pika 3, germa "b", të VKM nr.997, datë 10/12/2010, të evidentuara në pasqyrën ANEKS nr.1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimi.

Menjëherë

2. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **kthimi i vlerës 304,521 lekë nga 6 punonjës,** pagesa të përfituara nga ngritja në kategori e tyre, veprim ky në kundërshtim me pikën 11.11, Kreu III, të VKM nr. 686, datë 2/11/2005.

Menjëherë

3. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **kthimi i vlerës 110,000 lekë nga 3 punonjës,** pagesa të përfituara nga ngritja në kategori e tyre, veprim ky në kundërshtim të VKM-ve përkatëse "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë".

Menjëherë

4. Nga DPD të merren masa dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **në vlerën 48,960 lekë,** pasi zërat e punimeve të likuiduara me situacionin e riparimit për mjetin tip "Hynday" me targë TR1815N, në preventivin e ofertës për këtë tip mjeti janë pasqyruar "*zero*" në tenderin "Mirëmbajtje mjete transportit", në kundërshtim me dispozitat ligjore, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

5. Nga Dega e Doganës Kakavijë të merren masa dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **në vlerën 256,000 lekë,** e pasqyruar padrejtësisht në vlerën e kontratës së lidhur, veprim që rrjedh nga përllogaritja e gabuar e preventivit e pasqyruar nga njësia e prokurimit si pjesë e dokumenteve të tenderit e pranuar me konkurrim nga operatori ekonomik në preventivin e ofertës, si dhe **shumën 3,600 lekë si zë punimi i pa kryer,** por i likuiduar me situacionin përfundimtar të punimeve, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

6. Nga dega e doganës Kapshticë të merren masa dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **në vlerën 60,000 lekë**, e pasqyruar padrejtësisht në vlerën e kontratës e cila nuk duhet të likuidohet me situacionin përfundimtar, veprim që rrjedh nga përllogaritja e gabuar e preventivit të fondit limit e pasqyruar nga njësia e prokurimit si pjesë e dokumenteve të tenderit e pranuar nga operatori ekonomik në preventivin e ofertës konkurruese, në kundërshtim me dispozitat ligjore, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

C. <u>MASA DISIPLINORE</u>

C.1 *Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12/7/1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; në nenin 16, pika 6, të Ligjit nr. 8449, datë 27/1/1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", me ndryshime, dhe në*

pikën 16, Kreu 6, të VKM nr. 205, datë 13/4/1999 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor", ndryshuar me VKM nr. 686, datë 2/11/2005, ***kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:***

"Vërejtje me paralajmërim", dispozita 18.1.4, gërma "a", për:

1. Z. [redacted] ***me detyrë Drejtor i Organizim Personelit dhe Trajnimit,***
për arsye se:
- Nuk ka zbatuar detyrat funksionale, bazuar në pikën 4, neni 63, të Rregullores së Brendshme të DPD.
- Nuk ka bërë vlerësimin e dosjeve të disa punonjësve, në përputhje me kërkesat e pikës 11.7, të VKM nr. 686, datë 2/11/2005, me ndryshime dhe me nenin 63, të Rregullores së Brendshme të DPD, pikat 8, 9, 10 dhe 11 të saj.
- Nuk ka bashkëpunuar me Degët Doganore, në lidhje me azhurnimin e listës së punonjësve që ngrihen përkohësisht në kategori, kjo për efektet financiare të përfitimit të pagesave në kategori më të larta, gjë që ka sjell si pasojë përfitime të pagesave për disa punonjës, në kushtet e përfundimit të periudhës 3-mujore, periudhë që duhej të përfitohej financiarisht kjo pagesë, e shoqëruar me *një efekt negativ financiar në shumën 304,363 lekë për 6 punonjës.*
- Nuk ka zbatuar dispozitat ligjore në përmbushje të detyrave funksionale.

2. Z. [redacted] ***me detyrë Drejtor i Financës,*** për:
- Pagesa të kryera në kundërshtim me pikën 3, germa "b", të VKM nr. 997, datë 10/12/2010, *në shumën 4,932,000 lekë,* trajtuar hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
- Mos ndjekjen dhe mos kryerjen e inventarëve në zbatim të ligjit nr. 9228,datë 29/4/2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", trajtuar hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
- Mos sistemimin e veprimeve kontabël për Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara, ish parkingu në Degën Doganore të Tiranës *për vlerën 21,365,570 lekë,* rekomandim i dërguar nga KLSH me shkresën nr.10/8, datë 25/5/2010.

3. Z. [redacted] ***me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës,*** për:
- Pagesa të kryera në kundërshtim me pikën 3, germa "b", të VKM nr. 997, datë 10/12/2010, *në shumën 4,932,000 lekë,* trajtuar hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
- Mos ndjekjen dhe mos kryerjen e inventarëve në zbatim të ligjit nr. 9228,datë 29/4/2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve".

- Mos sistemimin e veprimeve kontabël për Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara, ish parkingu në Degën Doganore të Tiranës *për vlerën 21,365,570 lekë,* rekomandim i dërguar nga KLSH me shkresën nr.10/8, datë 25/5/2010.

C.2 *Për masat disiplinore ndaj punonjësve të përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit,* ***rekomandojmë që:***

- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, si autoriteti i vetëm për vlerësimin dhe dhënien e masave disiplinore, mbi bazën e kompetencave që i njeh ligji dhe mbi sa trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për personat e përmendur në këtë Raport Përfundimtar të procedojë për ecurinë e masave disiplinore.

Shënim: Auditimi u krye nga Kryeaudituesi z. Edvin Stefani Përgjegjës Grupi, dhe nga audituesit zj. Efrida Taraku, z. Bashkim Shehu, z. Vladimir Rizvani dhe z. Hekuran Avdulaj, anëtarë. Më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit z. Aleksandër Lipivani dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT